



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:232108

Datë: 19.02.2025

Numri i dokumentit: 06865396

P.nr.224/2024

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurës A.R.A. me vendbanim në komunën e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale *Sulmi* nga neni 184 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1268/24 e datës 20.08.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të datës 18.02.2025, në praninë e prokurorit të shtetit Shaqir Sedolli, të pandehurës A.R.A., avokatit mbrojtës sipas autorizimit av.Fatmire Braha, pala e dëmtuar F.A. si dhe mbrojtësi i viktimave nga ZMNV-Muhamet Përvetica, pas shpalljes së aktgjykimit me datë 18.02.2025, me datë 19.02.2025 përpiloi këtë

A K T G J Y K I M

E PANDEHURA: A.R.A. nga i ati S..., e ëma V..., e gjinisë B..., e data e lindjes... në Gjilan, tani me vendbanim në rr. "...", Komuna e Vushtrrisë, e martuar, nënë e një fëmiju, me profesion mësimdhënës në shkollën e mesme profesionale "B...", e gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer fakultetin master të arkitekturës dhe eficiencës së energjisë, me numër personal të identifikimit ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë e pagjykuar.

ËSHTË FAJTORE

SEPSE: Me datën 19.07.2024 rreth orës 18:00 minuta, në Vushtri, në rrugën "Ismail Qemajli", saktësisht në banesën e përbashkët me dashje përdor forcën ndaj të dëmtuarit-bashkëshortit F.A., si pasojë e mosmarrëveshjes të atë çastshme lidhur me përkujdesjen e fëmijës, në atë ashtu që pasi dëmtuari kthehet tek shtëpia e pandehura kishte filluar fillimisht të ofendon me fjalë, pastaj derisa kishte qenë duke biseduar në telefon me prindërit e të dëmtuarit i cili shkon për të marrë djalin e pandehura e sulmon duke e gërvishur me duar në gjoks si dhe në kraharor dhe në duar.

- Më këtë ka kryer veprën penale *Sulmi* nga neni 184 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 81, 82, dhe nenit 184 par 1 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 449, 460 të KPPK-së të pandehurit i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilën të pandehurës i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën vepër penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do të shqiptojë sanksion më të rëndë penal.

Pala e dëmtuar F.A. ka hequr dorë lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike në këtë çështje penale.

DETYROHET e pandehura që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëqind (100), euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.1268/24 e datës 20.08.2024, kundër të pandehurës A.R.A. me vendbanim në rr. "...", komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale *Sulmi* nga neni 184 par.1 të KPRK-së,

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 17.10.2024, ku prezent ka qenë prokurori i shtetit, e pandehura si dhe i dëmtuari, ku në atë seancë gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurën me të drejtat e saj në këtë çështje penale dhe pasi që është bindur se e pandehura i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë. E pandehura ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë.

Gjykata pasi që e pandehura nuk e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës, e ka informuar të pandehurën se jo më vonë se 30 ditë nga shqyrtimi fillestar ka të drejtë të paraqes kundërshtimet e tyre për provat e cekura ne aktakuzë, të paraqesë kërkesat për hedhjen e aktakuzës nëse është e ndaluar ligjrisht dhe të paraqesë kërkesën për hudhjen e aktakuzës për shkak të mos përshkrimit të veprës penale

Pasi që e njëjta nuk e ka ushtruar të drejtën e saj për të paraqitur kërkesë për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtim të provave brenda afatit ligjor 30 ditëve, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 18.02.2025

Deklarimi i të pandehurës lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit gjyqësorë të mbajtur më datë 18.02.2025, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi

bindet se e pandehura e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtës i ofron mundësinë e deklaramit rreth fajësisë, ashtu që: e pandehura ka deklaruar se e pranon fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, është penduar për kryerjen e kësaj veprë, i vjen keq për atë që ka ndodhur, dhe se i ka premtuar gjykatës se ne të ardhmen nuk do e përsëris më, raportet me të dëmtuarin janë të mira, kanë një fëmijë të përbashkët, jetojnë së bashku dhe se ka qenë e çastit ajo se çfarë ka ndodhur

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës ka deklaruar se i propozon gjykatës që të bëjë aprovimin e pranimit të fajësisë të bërë nga e pandehura, pasi që ky deklaram i saj gjene mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe është bërë pas konsultimit paraprak me avokaten mbrojtëse.

Mbrojtësi i viktimave lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës ka deklaruar se meqenëse palët jetojnë së bashku, i propozojnë gjykatës që ta aprovojë fillimisht pranimin e fajësisë dhe të shqiptoj një dënim i cili do të ketë sa më pak pasoja te palët,

I dëmtuari lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, kanë raporte të mira bashkëshortore dhe se heq dorë nga kërkesa pasurore juridike lidhur me këtë çështje,

Avokatja mbrojtëse lidhur me pranimin e fajësisë, e njëjta deklaron se e pranon pranimin e fajësisë nga e mbrojtura e saj pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të njëjtën, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimit të fajësisë ashtu që i propozojnë gjykatës që të miratojë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturës së saj.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga e pandehura, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se e pandehura i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga e njëjta, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit, me nr. të rastit 2024-BD-656, i datës 19.07.2024, raporti i oficerit, i datës 19.07.2024, raporti ditorë i dhunës në familje, i datës 19.07.2024, urdhër për mbrojtën e përkohshme emergjente, i datës 19.07.2024, procesverbal i marrjes në pyetje për të dëmtuarin, i datës 19.07.2024, procesverbal i marrjes në pyetje për të pandehurën, i datës 19.07.2024, foto-dokumentacioni në gjashtë shtojca, informacionet për të kaluarën kriminale për të pandehurën.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se e pandehura me dashje ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK -së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 184, par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale e kryen *“Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”*,

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurën ta shpall fajtores për kryerjen e veprës penale penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtës përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjëse.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore për të pandehurën në përputhje me nenin 81 dhe nenit 82 par.2 e lidhur me par.1 të KPRK-së, duke i bërë me dije kështu të njëjtës se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën veprën penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do të shqiptojë një sanksion më të rëndë penal. Po ashtu, gjykata mori parasysh edhe faktin se për veprën penale e cila të pandehurës me aktakuzë i vihet në barrë, parashihet dënim me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, ky për të cilin lejohet shqiptimi i vërejtjes gjyqësore në raport me rrethanat ekzistuese të rastit konkret.

Me rastin e caktimit të vërejtjes gjyqësore gjykata ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, premtimin e dhënë gjykatës se asnjëherë nuk do të përsëriten më veprime të tilla, pendimin e saj për kryerjen e veprës penale, faktin se e pandehura nuk ka të kaluar kriminale, sjellja korrekte në gjykatë, raporti i mirë bashkëshortor, faktin se e njëjta është nënë e një fëmiju të përbashkët me të dëmtuarin, po ashtu është mësimdhënëse në shkollën e mesme profesionale “B.H.”. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, e që në rastin konkret vepra është kryer me dashje si dhe se vepra është kryer brenda raportit familjar, bashkëshortor.

Me rastin e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore, gjykata morri parasysh qëllimin e shqiptimit të këtij sanksioni, duke vlerësuar se edhe me këtë sanksion do të arrihet qëllimi i sanksionit penal nga neni 81 lidhur me nenin 38 të KPRK-së, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Gjykata çmon se shqiptimi i një sanksioni të tillë është i mjaftueshëm për të ndikuar në parandalimin e të pandehurës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e të njëjtës, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të vërejtjes gjyqësore, të paraparë në nenin 82 të KPRK-së.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin lidhur me palën e dëmtuar gjykata e ka marrë në bazë të nenit 460 të KPPK-së ku është përcaktuar se *“Personat e autorizuar mund të tërhiqen nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe atë ta realizojnë në kontest civil. Kur propozimi tërhiqet, i njëjti propozim nuk mund të paraqitet përsëri, përveç nëse me këtë Kod është paraparë ndryshe.”*, kjo pasi që pala e dëmtuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 18.02.2025 ka hequr dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e morri në bazë të nenit 449 par.2 nën par.2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPPRK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e morri në bazë të nenit 36 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.224/2024, datë: 19.02.2025

Gjyqtari i vetëm gjykues
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit.